



**Këshilli Kombëtar për
Zhvillim Ekonomik**

Ndikimi Ekonomik i Pandemisë Covid-19 në Kosovë

Prishtinë, 10 prill, 2020

Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik

Mbështetur nga BERZH

Ndikimi Ekonomik i Pandemisë Covid-19 në Kosovë

Rritja pa COVID-19

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i Kosovës, në vitin 2019, ishte pak mbi €7 miliard. Projektionet e rritjes për 2020, nga Fondi Ndërkombëtar Monetar (FMN), ishin 4%. Ndërsa, Banka Botërore (BB) projektonte një rritje prej 4.2%. Këto shifra do të nënkuptonin një BPV real prej rreth 7.29-7.3 miliard euro në 2020.

Pasqyrë e treguesve makroekonomikë

Kosova hyn në krizën e Pandemisë COVID-19 me ekonomi relativisht të qëndrueshme dhe duke lënë pas një dekadë me rritje të vazhdueshme ekonomike. Bazuar në të dhënat e tremujorit të fundit të 2019, ekonomia e Kosovës shënoi një rritje prej 4,4% (vit pas viti) në tremujorin e tretë të 2019 në terma real.¹ Kjo rritje i është atribuar kryesisht konsumit dhe investimeve private dhe publike. Sa i përket kontributit specifik të secilit sektor, sektori i shërbimeve ka pasur në vazhdimësi kontributin më të madh pozitiv në rritjen reale të PBB, me rreth 2 pikë përqindje; e ndjekur nga industria (kryesisht prodhuese) me rreth 1 pikë përqindje, dhe sektori i ndërtimit me rreth 0.3 pikë përqindje, për këtë tremujor.²

Shëndeti i sektorit financiar ka qenë i qëndrueshëm edhe gjatë vitit 2019. Borxhi i sektorit privat ka vazhduar të rritet, i mbështetur nga një mjedis i qëndrueshëm makroekonomik dhe përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë. Zhvillimi i sektorit privat ka pasur trend pozitiv gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në Kosovë gjatë TM4 2019 ishte 2,566³. Ajo që është edhe më e rëndësishme është përbërja sektoriale e këtyre ndërmarrjeve, ku shihet se ndërmarrjet që operojnë në prodhim kanë shënuar rritjen më të lartë të ndërmarrjeve të reja.

Këta tregues tregojnë një trend pozitiv të ekonomisë së Kosovës dhe një ecuri të qëndrueshme të përgjithshme gjatë vitit të shkuar. Duke pasur parasysh urgjencën aktuale të shëndetit publik, ekonomia e Kosovës është e ekspozuar ndaj tronditjeve të jashtme që do të ndikojnë në sektorë dhe aspekte të ndryshme të ekonomisë.

¹ Banka Qendrore e Kosovës, Indikatorët Ekonomik, 2019

² Ministria e Financave, Buletini Makroekonomik, TM4, 2019

³ Ministria e Financave, Buletini Makroekonomik, TM4, 2019

Ndikimi negativ i pritshëm varet nga ashpërsia e masave mbrojtëse, kohëzgjatja e këtyre masave dhe e periudhës së izolimit, si dhe nga përgjigja e sektorit privat dhe e qeverisë së Kosovës për të stabilizuar ndikimin e këtyre goditjeve.

Punësimi

Gjatë vitit 2019, në bazë të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 363,180 persona ishin të punësuar në Kosovë. Në periudhën 2013-2019, rritja mesatare vjetore e punësimit ka qenë 2.91%. Meqë nuk ka parashikime për punësimin në 2020, le t'i bëjmë dy supozime. Supozimi i parë është që rritja e punësimit të jetë mesatarja e shtatë viteve të fundit dhe ndikimi i COVID-19 në punësim mund të jetë i njëjtë në përqindje sa në PBB, në bazë të parashikimeve vjetore të BQK-së. Kjo do të nënkuptonte se, po të mos ishte COVID-19, në vitin 2020 do të ishin mbi 10,500 më shumë të punësuar në 2019-ën. Por, për shkak të situatës me COVID-19, gjatë vitit 2020, mund të humben 17.8 mijë deri 25.1 mijë vende pune. Pra, papunësia do të mund të rritej për 14.2-20% apo nga 25.7% në 29.3-30.8%.

Analiza e sektorëve

Në të gjithë Evropën, pritjet për ndikimin ekonomik të pandemisë janë përqendruar në identifikimin e sektorëve më të goditur dhe hartimin e masave për të siguruar lehtësime ekonomike në periudhën e menjëhershme, si dhe pako fiskale stimuluese në të ardhmen, për këta sektorë. Në Kosovë, sektori me kontributin më të lartë në PBB-në e Kosovës është tregtia me shumicë dhe pakicë, duke kontribuar me rreth 20%, e ndjekur nga prodhimi me 17%, dhe ndërtimi me 13%.

Sidoqoftë, kontributi i përgjithshëm i sektorëve në PBB nuk është plotësisht në përputhje me pjesëmarrjen e fuqisë punëtore në secilin nga këta sektorë. Sipas ASK-së tre sektorët kryesorë si punëdhënës janë tregtia me shumicë dhe pakicë, që punëson rreth 17% të numrit të përgjithshëm, ndjekur nga ndërtimtaria me 13%, dhe prodhimtaria me 12%.⁴

Sektori i hotelerisë dhe restoranteve, i cili kontribuon rreth 2% në PBB-në e Kosovës, është punëdhënësi i katërt më i madh nga sektori privat, me 6% të të punësuarve. Duke pasur parasysh që ky sektor do të pësojë goditjen më të madhe nga masat mbrojtëse ndaj pandemisë, është e rëndësishme të theksohet se duhet të përpilohen masa specifike për të mbështetur sektorin, duke pasur parasysh numrin e madh të të punësuarve në sektor (26,600).

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2019

Parashikimet për ndikimin e pandemisë në ekonominë e Kosovës

BQK parasheh që Kosova, prej një periudhe të rritjet mesatare vjetore prej 3,6%, të ballafaqohet me rënie ekonomike prej 2% në rastin më të mirë dhe 4% në rastin më të rëndë.⁵

Analiza e ndikimit të pandemisë në ekonominë globale e realizuar nga BB e parasheh që Kosova, ngjashëm me trendët e rajonit, të pësojë rënie të PBB prej 1,6%.⁶

FMN ka publikuar parashikimin e ndikimit të pandemisë në ekonominë e Kosovës, me pritjet që ekonomia të pësojë një rënie prej 5%.⁷

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), me 26 mars 2020, ka parashikuar që 1 muaj e izolimit strikt (e.g. lockdown), mund të rezultojë me rënie të PBB-së prej 2 pikë përqindje. Kjo për Kosovën do të nënkuptonte €140-€147 milionë humbje mujore. Ndërsa, 3 muaj të izolimit strikt, do të nënkuptonin €420-441 milionë humbje.

Parashikime tjera

Për nevoja të këtij dokumenti është realizuar një analizë për ndikimin ekonomik të pandemisë, sipas sektorëve dhe kontributit të tyre në ekonomi dhe punësim. Skenari më i mundshëm, edhe në analizën e ndikimit ekonomik sipas sektorëve, parasheh tkurrje ekonomike prej 2% deri në 4%, që përputhet me parashikimet e BQK-së.

Parashikimet për ndryshimet në nivelin e papunësisë reflektojnë parashikimet e ndikimit ekonomik, por rrethanat që krijojnë një numër të madh të panjohurash, nuk lejojnë parashikim më specifik. Kështu, në skenarin më të mundshëm, niveli i papunësisë, për 2020, arrin normën 29% deri në 30%. Sidoqoftë, duhet të konsiderohet numri i vendeve të punës që mund të humben gjatë pandemisë dhe të rikuperohen në muajt pas, dhe këto shifra, në rastin më të mundshëm arrijnë mbi 80,000 vende pune. Nga sektorët që ndikohen më së shumti janë sektori i hotelerisë dhe shërbimit të ushqimit si dhe sektori i tregtisë me pakicë dhe shumicë, sektorë në të cilët mund të humben edhe numri më i madh i vendeve të punës.

Llogaritjet bazohen në të dhënat e vitit 2019, duke përdorur skenarë të ndryshëm të nivelit të funksionimit të sektorëve si dhe të kohëzgjatjes së izolimit. Ndikimi i pandemisë është krahasuar si me rritjen e parashikuar prej 4%, që të llogariten edhe

⁵ Banka Qendrore e Kosovës - Guvernatori Mehmeti prezantoi masat e BQK-së për tejkalimin me më pak dëme në ekonomi nga pandemia Covid 19, 2020

⁶ Banka Botërore, Luftimi i COVID, 2020

⁷ Fondi Monetar Ndërkombëtar, Bordi Ekzekutiv i FMN-së miraton 56.5 milion dollarë në ndihmë emergjente për Republikën e Kosovës për të adresuar Pandeminë COVID-19

humbjet potenciale të cilat Kosova ka mund t'i ketë, ashtu edhe kundrejt rritjes që është arritur në TM1, dhe atë potenciale në tremujorët tjerë jashtë izolimit. Kjo analizë tregon se ndikimi në PBB-në e Kosovës mund të sillet nga rënie prej 1% në skenarin më optimist dhe më pak të mundshëm, si për nga niveli i veprimtarisë së sektorit privat gjatë izolimit, ashtu edhe për nga kohëzgjatja e izolimit; në një rënie ekonomike prej rreth 6% të PBB-së në skenarin më të rëndë, në të cilin masat e izolimit në Kosovë zgjasin për 10 javë, ndërsa të gjithë sektorët ekonomik operojnë me kapacitet shumë më të ulët se atë që realisht e kanë.

Masat shtesë që Qeveria e Kosovës mund të merr parasysh

1. Të hartohen masa fiskale të synuara drejt mbështetjes së sektorëve më të goditur nga masat aktuale të shëndetit publik.
 - Qeveria e Kosovës mund të konsiderojë planifikimin e [skemave mbështetëse prioritare për sektorët](#), aktivitetet e të cilëve janë ndaluar plotësisht gjatë pandemisë. Mbështetja për këta sektorë duhet të përfshijë: sigurimin nga mundësia e dëbimit ose subvencionim të qirasë për një periudhë më të gjatë, mbështetje për kompensimin e punonjësve të regjistruar, si dhe mbështetje për rifillimin e aktiviteteve të tyre pasi të përfundojë izolimi.
 - Sektorët, siç janë [Hotelet dhe restorantet](#), kanë më shumë të ngjarë t'i nënshtrohen masave që shtesë të kujdesit, që zgjasin përtej periudhës së izolimit fillestar. Si rezultat, ky sektor, duke pasur parasysh nivelin e lartë të punësimit, mund të prioritizohet për tu mbështetur gjatë masave të izolimit, për të siguruar që periudha e rifillimit është më lehtë e përballueshme. Duke pasur parasysh që fuqia punëtore në këtë sektor është gjysmë e kualifikuar, procedurat e ri-punësimit ka të ngjarë të zgjasin kohën e nevojshme për rinisjen e punës së sektorit, dhe kështu edhe të rrisin koston për operatorët. Qeveria mund të hartojë masa të drejtuara për mbajtjen e punonjësve të punësuar në këtë sektor.
2. Të zhvillohet një [analizë e hollësishme e rimëkëmbjes pas pandemisë](#), bazuar në skenarë të ndryshëm të kohëzgjatjes së bllokimit dhe ndikimit të mundshëm në ekonomi.
 - Qeveria e Kosovës duhet të [rishikojë skemat sociale](#), duke pasur parasysh që numri i të papunëve në Kosovë do të rritet, linjat buxhetore për skemat sociale duhet të parashikojnë këtë rritje dhe të jenë në gjendje ta mbështesin atë. Duhet të kemi parasysh se përkundër faktit se qeveria ka stimuluar sektorin privat për të zyrtarizuar aktivitetet e tyre biznesore dhe posaçërisht punëtorët, për shkak të faktit që një numër i konsiderueshëm i njerëzve që do të humbasin punën kanë qenë të punësuar në sektorin joformal, kjo do të ketë një ndikim të ndikojë duke rritur më tej numrin e aplikacioneve për skemat e mbështetjes sociale.
 - Qeveria e Kosovës mund të hartojë një plan të detajuar të rimëkëmbjes, me masa specifike që synojnë injektimin e [jetës](#) në ekonominë e Kosovës. Plani, përveç ndihmës së synuar për sektorët ekonomikë, duhet të ketë gjithashtu hapa të detajuar për të mbështetur ekonominë familjare.

- Ndikimi negativ nga rënia e aktivitetit ekonomik nga pandemia mund të kufizohet nëse masat nga qeveria trajtojnë si anën e ofertës ashtu dhe anën e kërkesës në ekonomi.
 - Qeveria e Kosovës gjithashtu mund të zhvillojë skema [trajnimi dhe aftësimi](#) që targetojnë në mënyrë specifike personat që kanë humbur punën në sektorët që rriten gjatë pandemisë, për të përmirësuar aftësitë e tyre në treg dhe për t'i asistuar në punësimin pas krizës.
3. Qeveria e Kosovës ka [stimuluar bizneset për të zyrtarizuar punonjësit e tyre](#), për të siguruar që ata mund të përfitojnë nga skemat mbështetëse të qeverisë. Kjo masë është hap pozitiv në zvogëlimin e informalitetit në ekonominë e Kosovës; sidoqoftë, duhet të përcillet me garanci nga Qeveria se bizneset që deklarojnë punëtorë të padeklaruar gjatë kësaj kohe nuk do të ndëshkohen nga inspektoratet.
- Kjo garanci mund të rrisë numrin e bizneseve të gatshme të deklarojnë punëtorët e tyre dhe t'u sigurojnë atyre kontrata për një vit. Si rezultat, masa jo vetëm që do të ketë ndikimin e dëshiruar, por gjithashtu do të krijojë një efekt shumëzues, duke përmirësuar situatën edhe për bizneset dhe punëtorët.
4. Të diskutohet tutje me Institucionet Ndërkombëtare të Financimit (IFI) dhe sigurohet mbështetja që targeton sektorët ekonomikë që kanë më shumë nevojë.
- Raporti aktual i borxhit ndaj PBB-së në Kosovë qëndron në një normë prej 17.4%, duke i dhënë hapësirë potenciale Kosovës për huamarrje ndaj PBB-së aktuale, për të financuar deri në një masë ndikimin negativ nga pandemia. Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh që Kosovës i [mungon vlerësimi kreditor](#) dhe ka një nivel shumë të ulët të zhvillimit ekonomik, që prezanton problem në mundësitë e financimit.
 - [Huamarrja e kufizuar](#) mund të synohet në tre fusha kryesore: mbështetje për sektorin privat, mbështetje për stabilitetin makroekonomik, dhe mbështetje nga ana e kërkesës.
 - Duke pasur parasysh që Kosova konsiderohet të ketë qëndrueshmëri të lartë sa i përket politikave fiskale dhe ka një sistem financiar mjaft stabil, mund të pritet që vendi të ketë aftësinë për të zbatuar politika fiskale që ndihmojnë periudhën e rimëkëmbjes. Mbështetja e anës së kërkesës mund të financohet nga buxheti i Kosovës, nëse [buxheti rishikohet](#) për të siguruar që investimet jo-thelbësore kapitale mund të shtyhen dhe që buxheti i planifikuar është riridestinuuar për skema mbështetëse për familjet dhe individët.

5. Të konsiderohet të zhvillohet **rregulli i ngrirjes së qirave**, si për bizneset ashtu edhe për individët. Ngrirja duhet të sigurojë që asnjë palë të mos dëbohet gjatë kohës së pandemisë dhe borxhi i qirasë së papaguar do të paguhet deri në fund të vitit 2020.
- Në këtë mënyrë, Qeveria mund të ri-drejtojë mbështetjen e planifikuar për **mbulimin e qirave**, drejt aktiviteteve produktive, duke siguruar në të njëjtën kohë mbështetje për të gjitha bizneset private, pavarësisht nga madhësia e tyre, si dhe familjet, për sa i përket qirasë.